**AKT THEMELIMI**
**I**
**SHOQËRISË TREGTARE**
**NORD PILOT SH.P.K**
**ME SELI NË DURRES**

Sot, më datë 01/09/2021 (dymijë e njezetenje), ortaku:

Z. Krenar Osmani, i biri i Xhevat, i lindur më Peshkopi, banues në Durrës, në Rrugën: L 16,Rr.AbazÇelkupa,P1004 Durres, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimi nr; 033375714 me nr. Personal:H81119111V ;

I cilipërpiloi ne këtë kontrate themelimi të shoqërisë tregtare NORD PILOT Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqërinë Tregtare NORD PILOTSH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 2**
**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin NORD PILOTSH.P.K

**NENI 3**
**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisësë shoqërisë shtrihet nëfushat e mëposhtme:

Organizimin e kryerjes se sherbimitprivattepilotimitdheormexhimit per anijetqehyjnedhedalin ne portet e Republikes se Shqiperise. Të gjitha vaprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

**NENI 4**
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Durrës, në adresën: Porti Detar Durres, Kalata Nr.5

**NENI 5**
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100.000 (njeqind mijë) lek, e ndarë në 1 kuotë. Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

1. **Z.** Krenar Osmani në cilësinë e ortakut themelues zotëron **100%** të vlerës së kuotave në kapitalin themeltar ose 1 kuotë të barabarta me vlerë prej 100.000 lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku Themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga vete ai.

**NENI 6**
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

**NENI 7**
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë Z. Erjon Dhana, i biri i Gjergj, i lindur më Lezhë e banues në Durrës, në Rrugën P.Foto/8 nr 5/316 Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftimi nr 034743708, me nr. Personal: I10710108M,

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

**NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 9**

Ortaku detyrohet të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 10**
**Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**NENI 12**
**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua dhe firmos me vullnet të lirë nga Ortaku Themelues.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

KREHAR OSMANI